ALBPETROL SH.A.

Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

A K T I V E T	Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2016	Viti ushtrimor 31.12.2015
Aktivet Afatshkurtra			
Aktivet monetare	1	**23,557,466**	**10,805,685**
1 *Banka*		23,208,402	10,183,296
2 *Arka*		349,064	622,389
Investime	2	**0**	**0**
1 *Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit*	2.1		
2 *Aksionet e veta*	2.2		
3 *Te tjera Financiare*	2.3		
Të drejta të arkëtueshme	3	**20,986,028,799**	**19,609,685,104**
1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit*	3.1	15,831,502,434	16,092,611,420
2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit*	3.2		
3 *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*	3.3		
4 *Të tjera*	3.4	5,154,526,366	3,517,073,683
5 *Kapital i nënshkruar i papaguar*	3.5		
Inventarët	4	4,148,231,610	2,947,502,069
1 *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme*	4.1	259,435,664	335,378,374
2 *Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte*	4.2	35,760,001	30,313,689
3 *Produkte të gatshme*	4.3	2,249,402,243	969,447,019
4 *Mallra*	4.4	1,603,633,702	1,612,362,987
5 *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)*	4.5		
6 *AAGJM të mbajtura për shitje*	4.6		
7 *Parapagime për inventar*	4.7		
Shpenzime të shtyra	5	0	
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	6		
TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		25,157,817,875	22,567,992,858
Aktivet Afatgjata			
Aktive financiare	7	0	0
1 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit*	7.1		
2 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit*	7.2		
3 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*	7.3		
4 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*	7.4		
5 *Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata*	7.5		
6 *Tituj të tjerë të huadhënies*	7.6		
Aktivet materiale	8	**46,621,285,159**	**47,912,536,865**
1 *Toka dhe ndërtesa*	8.1	16,676,110,182	16,852,138,797
2 *Impiante dhe makineri*	8.2	29,035,046,113	29,868,105,448
3 *Të tjera Instalime dhe pajisje*	8.3	910,128,864	1,192,292,620
4 *Parapagime për aktive materiale dhe në proces*	8.4		
Ativet biologjike	9	120,833	120,833
Aktive jo materiale:	10	30,145,428	0
1 Koncesione,patenta,licenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme	10.1		
2 *Emri i Mirë*	10.2		
3 *Parapagime për AAJM*	10.3	30,145,428	
Aktive tatimore të shtyra	11		
Kapitali i nënshkruar i papaguar	12		
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		46,651,551,420	47,912,657,698
AKTIVE TOTALE		71,809 ,369,295	70,480,650,556

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

DETYRIMET DHE KAPITALI		Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2016	Viti ushtrimor 31.12.2015
Detyrime afatshkurtra:		13	1,223,232,315	959,679,074
1	*Titujt e huamarrjes*	*13.1*		
2	*Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*	13.2		
3	*Arkëtime në avancë për porosi*	*13.3*		
4	*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*	13.4	1,001,931,490	493,791,568
5	*Dëftesa të pagueshme*	*13.5*		
6	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*	13.6		
7	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*	*13.7*		
8	*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore*	13.8	113,699,455	125,907,546
9	*Të pagueshme për detyrimet tatimore*	*13.9*	107,601,370	63,815,413
10	*Të tjera të pagueshme*	*13.10*		276,164,547
Grante		*15*	71,730,982	75,851,892
Te ardhura koncesionare te llogaritura		15		1,792,491,648
Provizione		*16*		
Totali i Detyrimeve afatshkurtera			1,294,963,297	2,828,022,614
Detyrime afatgjata:		*17*	11,627,330,992	11,261,834,048
1	*Titujt e huamarrjes*	17.1	138,989,209	138,989,209
2	*Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*	*17.2*		
3	*Arkëtimet në avancë për porosi*	17.3		
4	*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*	*17.4*	8,259,275,999	7,958,424,849
5	*Dëftesa të pagueshme*	17.5		
6	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit k/parti banesa*	*17.6*		
7	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomikek/pati j perd.*	17.7	240,098,860	451,617,613
8	*Të tjera të pagueshme*	*17.8*	2,988,966,924	2,712,802,377
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		***18***		
Të ardhura të shtyra		**19**		
Provizione:		***20***	**30,000,000**	**30,000,000**
1	*Provizione për pensionet*	20.1		
2	*Provizione të tjera*	*20.2*	30,000,000	30,000,000
Detyrime tatimore të shtyra		**21**		
Totali i Detyrimeve afatgjata			11,657,330,992	11,291,834,048
DETYRIMET TOTALE			12,952,294,289	14,119,856,663
1	*Kapitali dhe Rezervat*			
2	*Kapitali i Nënshkruar*	23	14,701,929,000	13,360,997,000
3	*Primi i lidhur me kapitalin*	24	-147,190,368	14,126,414,147
4	*Rezerva rivlerësimi*	25	43,201,518,459	29,537,324,906
5	*Rezerva ligjore*	26.1	538,768,533	307,701,642
6	*Rezerva statutore*			
7	*Rezerva të tjera*	26.3	909,718,506	2,840,785,397
8	*Fitimi i pashpërndarë*	27	-1,880,101,372	-3,813,605,691
9	*Fitim / Humbja e Vitit*	28	1,532,432,248	1,176,492
Totali i Kapitalit			58,857,075,006	56,360,793,893
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT			71,809,369,295	70,480,650,556

Pasqyra e Performancës

(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2016	Viti ushtrimor 31.12.2015
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	**2,254,945,978**	**3,257,930,890**
	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	30	**1,285,401,536**	**-42,140,798**
	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	31	**100,941,447**	**15,171,031**
	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32	**1,740,289,776**	**-129,244,209**
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	-931,306,279	-852,609,911
1	*Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme*	33.1	-931,306,279	-852,609,911
2	*Të tjera shpenzime*	33.2		
	Shpenzime të personelit	34	-1,485,508,632	-1,568,109,157
1	*Paga dhe shpërblime*	34.1	-1,313,781,473	-1,390,005,352
2	*Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)*	34.2	-171,727,159	-178,103,805
	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	35		
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	-484,898,670	-478,084,281
	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	-1,003,448,581	-420,128,621
	Të ardhura të tjera	38	56,015,673	218,391,548
1	*Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*	38.1		
2	*Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*	38.2		
3	*Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*	38.3	56,015,673	218,391,548
	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	39		
	Shpenzime financiare	40	0	0
	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	40.1		
	Shpenzime të tjera financiare	40.2	0	0
	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41		
	Fitimi/Humbja para tatimit	42	**1,532,432,248**	**1,176,492**
	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	**0**	
1	*Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin*	43.1		
2	*Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë*	43.2		
3	*Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve*	43.3		
	Fitimi/Humbja e vitit	44	**1,532,432,248**	**1,176,492**
	Fitimi/Humbja për:	45		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	45.1		
	Interesat jo-kontrolluese	45.2		

Pershkrimi	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	**13,360,997**	**14,128,241**	**29,539,004**	**240,894**		**1,931,067**	**1,299,598**	**0**			**60,499,801**
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël											**0**
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015	**13,360,997**	**14,128,241**	**29,539,004**	**240,894**		**1,931,067**	**1,299,598**	**0**			**60,499,801**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit											
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											**0**
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											**0**
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											**0**
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		-1,827	-1,679	66,807		909,719	-5,113,204	1176			**-4,139,008**
Dividendë të paguar											**0**
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											**0**
											0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	**13,360,997**	**14,126,414**	**29,537,325**	**307,701**	**0**	**2,840,786**	**-3,813,606**	**1,176**	**0**	**0**	**56,360,793**
											0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	**13,360,997**	**14,126,414**	**29,537,325**	**307,701**	**0**	**2,840,786**	**-3,813,606**	**1,176**	**0**	**0**	**56,360,793**
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											**0**
Fitimi / Humbja e vitit											**0**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											**0**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											**0**
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	1,340,932	-14,273,605	13,664,194	231,067		- 1,931,067	1,933,505	1,531,256			**2,496,282**
Dividendë të paguar											**0**
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											**0**
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	**14,701,929**	**-147,191**	**43,201,519**	**538,768**	**0**	**909,719**	**-1,880,101**	**1,532,432**	**0**	**0**	**58,857,075**

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare

Pershkrimi i Elementeve	Sheni met	Viti ushtrimor 31.12.2016	Viti ushtrimor 31.12.2015
luksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
itim / Humbja e vitit		**1,532,432,248**	**1,176,49**
regullimet për shpenzimet jomonetare:			
hpenzimet financiare jomonetare			
hpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-	
hpenzime konsumi dhe amortizimi		484,898,670	478,084,28
hvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
hpenzim tatim fitimi		-	
uksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
dryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
ënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(1,376,343,696)	(2,483,957,708
ënie/(rritje) në inventarë		(1,200,729,541)	3,819,275,49
ritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		637,137,365	(1,040,808,239
ritje/(rënie) në detyrime për punonjësit dhe te tjera		(12,208,091)	51,849,42
e ardhura te shtyra		(1,792,491,648)	1,792,491,64
jete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		**(1,727,304,693)**	**2,618,111,39**
uksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
agesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		831,046,790	97,461,557
këtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
këtime nga shitja e investimeve të tjera			
ete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		**831,046,790**	**97,461,557**
uksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
këtime nga emetimi i kapitalit aksionar		1,340,932,000	
a të arkëtuara		0	1,046,806
mi i lidhur me kapitalin		(14,273,604,515)	(1,827,293)
zerva rivleresimi		13,897,697,872	(2,838,758,627)
eres i paguar / arketuar		(56,015,673)	(218,391,548)
gese dividenti		-	-
ete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		909,009,684)	**(3,057,930,662)**
tje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		12,751,781	(342,357,707)
ete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2016		10,805,685	353,163,392
kti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare			
ete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016		**23,557,466**	**10,805,685**

Drejtori i Drejtorise Finances

Panajot BOÇI

ADMINISTRATORI

Endri PUKA

Informacione te pergjithshme

Albpetrol sha (Shoqeria)eshte nje shoqeri anonime shqiptare qe ka per objekt kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure ne perputhje me Ligjin Nr-7746, date 28.08.1993 per Kerkim , Zhvillim, Prodhim, Trajtimin, Transportin, Magazinimin dhe Shitjen e naftes Brut, Gazit dhe Rerave Bituminoze brenda dhe jashte REPUBLIKES SE SHQIPERISE si dhe cdo operiacion tjeter tregtar apo sherbime qe i sherbejne aktivitetit te shoqerise. Shoqeria brenda hapsirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi kryen cdo operacion projektues – preventivues, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejteperdrejt ose terthorazi me objektin e saj . Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarise dhe krijimin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit si dhe cdo aktivitet tjeter te mundshem e te ligjshem ne perputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit te veprimtarise te shoqerise behet nepermjet shfrytezimit dhe zhvillimit te zonave ekzistuese naftembajtese dhe ato gazmbajtese te vendit, kerkimeve te reja, zhvillimit te blloqeve ne administrim si dhe shfrytezimit te rerave bituminoze, furnizimit me energji elektrike te klienteve te kualifikuar, tregtimin e energjise elektrike, transmetimin e gazit natyror, shperndarjen e gazit natyror,leje mjedisore per veprimtari me diktim ne mjedis per vendburimet e naftes ne zonat Kucove, Patos-Marinez (Drize +Goran), Ballsh Hekal, Amonice Gorisht, per vendburimet e gazit ne zonen Divjak – Lushnje, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq –Sarand, rrjeti i transmetimit te produkteve te naftes dhe te gazit., vendburimi i reres bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucove dhe Uzina Mekanike Patos.

Shoqëria është themeluar në bazë të Vendimit të Gjykatës Nr. 21158 datë 8 Prill 1999 sipas regjistrit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është ne adresën Patos, Fier.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,701,929,000 leke, i ndare ne 14,701,929 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Leke.

Aksionet e Shoqerise ALBPETROL Sh.a janë nën pronësinë e Shtetit Shqiptar te përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Me VKM nr.848,date 07.12.2016 " Per krijimin e shoqerise "Albgaz" sha dhe percaktimin e autoritetit publik qe perfaqeson shtetin si pronar te aksioneve te shoqerive "Albpetrol" sha dhe "Albgaz" sha, botuar ne fletoren zyrtare nr 239, date 13 .12. 2016 si dhe me Urdher Nr. 415, date 15.12.2016 te Ministrise se Energjise dhe Industrise, aksionet e shoqerise "Albpetrol" sha transferohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik ,Tregtise dhe Sipermarrjes, ne Ministrine e Energjise dhe Industrise.

Ky ndryshim eshte regjistruar ne QKB me nr ceshtje CN-073769-12-6, date 16.12.2016.

Drejtuesit e Shoqërisë jane si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Bordi i Drejtorëve

Këshilli Mbikëqyres aktual i ALBPETROL sha përbëhet si më poshtë:

1.	Koli	BELE	Anëtar
2.	Dritan	SPAHIU	Anëtar
3.	Ermal	ELEZI	Anëtar
4.	Andius	OLLDASHI	Anëtar
5.	Ergys	QIRICI	Anetar
6.	Ilia	GJERMANI	Anetar
7.	Izet	SHAMETI	Anëtar

Administratori i shoqërisë: Endri PUKA

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, te cilit, i përkasin te gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet.

Gjate periudhës 01.01.2016 deri me 31.12.2016 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj ne përputhje me objektin e krijimit te saj.

Ne përputhje me veprimtarinë dhe organizimin administrativ, shoqeria ka organizuar kontabilitetin ne 13 njesi vartëse ose qendra, te cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare me vete dhe nxjerrin rezultat te vecante. Ne Qender, shoqeria përgatit Pasqyren Financiare permbledhese te bilanceve kontabel te njësive te saj. Kontabiliteti ne Qender eshte i informatizuar, ndërsa ne njesite vartëse mbahet ne menyre te përzier, manuale dhe te informatizuar.
Emertimi i njesive vartese eshte si me poshte:

1-QPN Patos	(Qendra Prodhimit te Naftes Patos)
2-QPN Kucove	(Qendra Prodhimit te Naftes Kucove)
3-QPN Ballsh	(Qendra Prodhimit te Naftes Ballsh)
4-QASHNG	(Qendra Administrimit te Shitjes Nafte e Gaz)
5-QAR	(Qendra Administrimit dhe Ruajtjes se Prones)
6-QSHGJ	(Qendra e Sherbimeve Gjeofizike)
7-QFSHE	(Qendra e Furnizimit dhe Sherbimeve Elektrike)
8-QEMNG	(Qendra Emergjences ,Mjedisit,Naftes e Gazit
9-QFMT	(Qendra Furnizimit Materialeve Teknike)
10-QT Patos	(Qendra e Transportit)
11-QMN Kucove	(Qendra Mekanike Naftes Kucove)
12-QTG Patos	(Qendra Transmetimit te Gazit)
13-Administrata Albpetrol	

Auditi i brendshëm
Ne shoqërinë Albpetrol sh.a. ekzistojnë procedura dhe programe qe synojnë te ndikojnë ne mbrojtjen e pasurise, ruajtjen e interesave te pronarit te vetem, zbulimin e anomalive dhe parregullsive, saktësimin e informacioneve ekonomiko-financiare, etj.

Për ndjekjen e kësaj pune vepron Departamenti i Auditit te Brendshem, i cili ka varësi te plote nga Keshilli Mbikqyres. Ky i fundit orienton, harton dhe miraton programet dhe planet e kontrollit për Departamentin e Auditit te Brendshem, i cili eshte pjese e kontrollit te përgjithshëm shtetëror dhe ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve, vendimeve te Keshillit te Ministrave dhe metodikave te hartuara nga strukturat e ngarkuara nga Keshilli i Ministrave për këtë qellim. Auditi i brendshëm nuk eshte ne përbërjen e strukturave te tjera te shoqërisë ALBPETROL SH.A.

Kështu gjate vitit 2016 Departamenti i Auditit te Brendshem ka kryer kontrolle te plota ekonomike dhe financiare sipas programit te hartuar dhe kane nxjerre rezultatet e tyre.

Bazuar ne strategjinë e zhvillimit te shoqërisë, ku prioritet i veçantë i është dhënë thithjes se investimeve te huaja, edhe gjate vitit 2016 ka vazhduar bashkëpunimi i shume kompanive te huaja me eksperience ne zhvillimin e vendburimeve te naftës dhe te gazit për kërkim-zbulimin e zhvillimin e vendburimeve qe administron Albpetroli,ne zbatim te Marrëveshjeve Hidrokarbure me kompanitë "Bankers Petroleum Albania" Ltd, "Transatlantic"Ltd, "Sherwood" , "Transoil Group" dhe "Phoenix", nga momenti i fillimit te marrëveshjeve dhe deri me 31.12.2016.

Tabela e mëposhtme jep numrin e puseve sipas çdo kompanie qe vepron ne baze te Marrëveshjes se Hidrokarbureve:

Nr	*Emertimi Kompanise*	*Nr i puseve të dorëzuar deri në fund të vitit 2015*	*Nr i puseve të dorëzuar* *në vitin 2016*	*Nr i puseve të dorëzuar deri në fund të vitit 2016*
1	***Bankers Petroleum***	*1135*	*0*	*1135*
2	***Transatlantic ltd***	*391*	*0*	*391*
	a) Vendburimi CA-MO	*69*	*0*	*69*
	b) Vendburimi BA-HE	*23*	*0*	*23*
	c) Vendburimi GO-KO	*295*	*0*	*295*
	d) Vendburimi Delvine	4	0	4
3	***Sherwood***	*94*		*94*
4	***Transoil ltd***	*235*	*0*	*235*
5	***Phoenix Petroleum***	*490*	*0*	*490*
	Gjithesej	*2736*		*2736*

Baza e Përgatitjes se pasqyrave Financiare

Baza e pergatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit Nr.9228,dt.29/04/2004 "Mbi Kontabilitetin" dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), te aprovuara dhe te shpallura per zbatim nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit (KKK).

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike,duke e kombinuar me elemente te metodave te tjera dhe parimin e te drejtave te konstatuara.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes të pasqyrave financiare te Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe perllogaritje, të cilat kane efekte ne aplikimin e politikave kontabel dhe ne vlerat e aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe perllogaritjet jane bazuar ne pervojen e meparshme dhe ne faktore te tjere, te cilet drejtimi i Shoqerise i konsideron te arsyeshem sipas rrethanave. Rezultatet e tyre perbejne bazen per vleresimin e vleres per tu mbartur te aktiveve dhe detyrimeve per te cilat nuk jane dhene informacione shpjeguese ne burime te tjera. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga vleresimet qe ishin bere.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme.Efektet qe rrjedhin nga rishikimi i vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte ripare dhe ne çdo periudhe te ardhshme .

Përmbledhje e politikave kontabël

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.
Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.
Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërise dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.
Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.
Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

Aktivet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit.Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit(duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.
Në fund të periudhës raportuese,matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit, (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar,matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.
Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.
Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit),rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi,në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet financiar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata.

Inventarët

Inventari eshte paraqitur me vleren me te ulet mes kostos dhe vleres se realizueshme neto.Vlera e realizueshme neto eshte cmimi i shitjes i perllogaritur gjate rrjedhes normale te biznesit pa koston e perllogaritur te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto eshte llogaritur si vijon:

Lendet e para	–	Me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
Prodhime ne proces	–	Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar
Produkt i gatshëm	–	Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar

Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, përveç tokës, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi.
Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Kostot përfshijnë shpenzime qe janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivit. Kostot e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe te fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër qe lidhet direkt me vënien e aktivit ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen përkatëse.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivlerësuara shiten, sasitë e përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimit te periudhës.

Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për ndërtesat dhe lidhjet teknologjike, puset, tubacione, mbi bazën e jetës se dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me një norme amortizimi siç shpjegohet me poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit me te cilat punon shoqeria :

	2016	2015
Baze lineare		
• Ndërtesa	1.5%	1.5%
• lidhjet teknologjike, puset, tubacione	1.5%	1.5%
Metoda zbritëse		
• Makineri dhe pajisje	2.5%	2.5%
• Pajisje, e te tjera	3 %	3 %

Aktive afatgjata jo materiale

(c) Emri i mire

Emri i mire njihet ne blerjen e filialeve, *joint ventures* dhe aktiviteteve.

Emri i mire përfaqëson tepricën midis kostos se blerjes me interesin e Shoqërisë ne vlerën e drejte te aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve te mundshme te shitësit. Ne rast se teprica është negative (emri i mire negativ) është njohur menjëherë ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Matja pas njohjes fillestare

Emri i mire matet me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi.

Amortizimi

Aktivet Afatgjata Jo materiale te cilat kane një jetë te dobishme te fundme, janë vlerësuar si diference e vierës historike me amortizimin e akumuluar dhe humbjeve nga zhvlerësimi. Amortizimi është njohur si shpenzim ne mënyrë lineare ne baze te jetës se dobishme te aktivit nga data qe aktivi ka qene ne dispozicion te Shoqërisë.

-Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohen në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji, mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zerat ne monedhë te huaj përkthehen si me poshtë:zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin
Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kursi i këmbimit, i përdorura nga shoqeria për monedhen USD më 31.12.2016 eshte , 1 USD =128.17 leke,

Instrumentat Financiare

Instrumentat financiare jo- derivative

Instrumentat financiare jo- derivative perfshijne investimet ne aksione, kerkesa te arketueshme nga klientet, te tjera kerkesa te arketueshme, mjete monetare dhe te ngjashme, kredi te dhena dhe te marra, llogari te pagueshme te te treteve.

Instrumentat financiare jo-derivative jane njohur fillimisht me vleren e drejte plus te gjitha kostot e transaksionit qe i perkasin ne menyre te drejtperdrejte.

Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare perfshijne gjendjet e llogarive dhe depozitat qe mund te terhiqen menjehere. Ekuivalente te mjeteve monetare perfshijne gjithashtu depozita afatshkurtra me pak se tre muaj.

Investimet te prezantuara me vleren e drejte nepermjet pasqyrese se te ardhurave

Nje instrument financiar eshte klasifikuar si i vleresuar me vleren e drejte nepermjet pasqyres se te ardhurave nese eshte i mbajtur per t'u shitur. Instrumentat financiare percaktohen si te vleresuar me vleren e drejte nepermjet pasqyres se te ardhurave nese Shoqeria i manaxhon keto investime dhe merr vendimet per blerjen dhe shitjen e tyre bazuar ne vleren e drejte. Pas njohjes fillestare, kostot e lidhura drejpersedrejti me transaksionin njihen si te ardhura dhe shpenzime kur ato ndodhin. Keto instrumenta financiare vleresohen me vleren e drejte dhe ndryshimet perkatese njihen si te ardhura ose shpenzime te periudhes ushtrimore.

Te tjera

Instrumentat e tjere financiare jo derivative vleresohen me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus humbjen nga rivleresimi, si me poshte:

Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjerat jane paraqitur me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvleresimi. Pasqyrat financiare perfshijne provizione speciale ne lidhje me llogarite e arketueshme te dyshimta, te cilat sipas opinionit te organeve drejtuese te Shoqerise, reflektojne ne menyre te mjaftueshme humbjen e perfshire ne ato llogari , mbledhja e te cilave eshte e dyshimte. Percaktimi i mjaftueshmerise se provizionit nga ana e organeve drejtuese eshte bazuar, nder te tjerave edhe ne vleresimin e rrezikshmerise, duke konsideruar informacionin ne dispozicion per bilancin e debitorit, volumin e aktivitetit te tyre tregtar dhe garancive te marra prej tyre.

Llogarite e arketueshme afatgjata jane deklaruar me vleren e tyre aktuale.

Transaksionet me palet e lidhura

Mardheniet me palet e lidhura jane trajtuar ne menyre te pershtatshme dhe paraqitur sipas SNK 24.

Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që u sigurojnë përfitime pensioni punonjësve pas daljes në pension. Kontributet e Shoqërisë në planin e përfitimit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ndodhin.

Provizionet për rreziqet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose te tërthortë) si rezultat i një ngjarje ne te kaluarën dhe ka mundësi qe lo te nevojitet një fluks burimesh qe përfshin përfitimet ekonomike për te përmbushur detyrimin dhe ne këtë mënyrë mund te behet një ërllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit. Ne rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e ritshme te parasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore te parasë ne kushtet aktuale te tregut dhe, aty ku

është e përshtatshme, normën e riskut te pasiveve specifike. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nëse nuk ka me mundësi për nevojen e një fluksi burimesh qe përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin qe janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen

Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Njohja e të ardhurave

Mallrat e shitur

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Te ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejte te pagesave te arkëtuara ose për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura eshte njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojne ne nje pjese te rendesishme bleresit, marrja e konpesimit eshte e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te maten me besueshmeri dhe nuk ka me perfshirje te vazhdueshme te drejtimit te Shoqerise me keto produkte.

Të ardhurat nga qiraja

Kosto fikse te qerase për këto linja te lidhura shpenzohen ne baze te metodës lineare mbi kushtet e qerase. Shpenzimet e lindura nga qiratë operative njihen ne pasqyrën e te ardhurave ne baze te metodës lineare sipas kohëzgjatjes se qirasë.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atëherë kur ndodhin.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe të ardhurat nga këmbimi valutor që njihen si fitime ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazë rrjedhëse, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga këmbimi valutor.

Tatim Fitimi

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyre. Tatim fitimi njihet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël te tatimit për t'u paguar ne lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjelle diferenca te përkohshme midis vlerës kontabël te aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare te aktiveve dhe pasive qe nuk kane asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit te shtyre bazohet ne mënyrën e pritshme te realizimit apo shlyerjes se shumes se akumuluar te aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore ne fuqi ne datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit te shtyre njihet vetëm nëse ka te ngjare qe fitimet e ardhshme te tatueshme do te jene ne dispozicion, e ndaj te cilave aktivi mund te përdoret. Aktivet e tatimit te shtyre reduktohen deri ne shkallen ku nuk është me e mundur qe te realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

- ***Çmimet e naftës dhe gazit***

Gjate vitit 2016,Shoqeria ka shitur nafte bruto mbështetur ne kontraten nr .3768/14, dt.25/05/2015, lidhur midis Albpetrol sha dhe shoqerise TPD- Trade Petrol & Drilling ,si dhe kontratave nr.531/10, dt.02/03/2016 dhe nr. 7805/15, date 17.12.2016 te lidhura midis Shoqerise Albpetrol sha dhe shoqerise Porto Romano Oil.

S 1 **Mjete monetare(likuiditete ne arke,banke)**

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke ne fillim dhe ne fund te ushtrimit jane si me poshte

S1 Aktivet monetare		**1**	**Viti Ushtrimor 31.12.2016**	**Viti Ushtrimor 31.12.2015**
	Banka		23,208,402	10,183,296
	Arka		349,064	622,389
	Totali		**23,557,466**	**10,805,685**

Gjendjet e llogarive te paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund te ushtrimit.Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te shpallur nga Banka e Shqiperise me 31/12/2016 dhe diferencat jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

S 3 Te drejta te arketueshme

S3	**Të drejta të arkëtueshme-Nga aktiviteti i shfrytëzimit**	**3**	**Viti Ushtrimor 31.12.2016**	**Viti Ushtrimor 31.12.2015**
	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	*3.1*	**17,382,101,610**	**17,643,210,596**
	Deri 1 vit		973,835,492	1,356,859,218
	Mbi 1 vit		16,408,266,119	16,286,351,378
	Zhvleresimi kerkesave te arketueshme		-1,550,599,176	-1,550,599,176
	Totali		**15,831,502,434**	**16,092,611,420**

Te drejta te arketueshme paraqesin kerkesat e vlefshme ndaj debitoreve per shitjet e mallrave apo sherbimeve ne daten e mbylljes se bilancit.(shih pasqyren analitike)
Zhvleresimi i kerkesave te arketueshme paraqet provizionet e krijuara per kerkesat e arketueshme.

Ne vitin 2011,mqs debitore pa shprese arketimi rezultojne te jene 642,939,837 leke dhe ne pasqyrat financiare te shoqerise te vitit 2010, provizione per kerkesa te arketueshme jane 228,831,368 leke,u krijua provizion ne vleren 414,108,469 leke.Pra ne PF te shoqerise ne vitin 2011, provizione per kerkesa te arketueshme , jane 642,939,837 leke.

Ne vitin 2014 me vendim nr.117,dt.17/03/2015 jane krijuar provizione :
-18,621,860 leke per punonjesit e dale te papune si pasoje e zbatimit te VKM nr.106,dt.01/02/2012 .
-35,187,106 leke per vendime gjyqesore te pritshme per t'u fituar nga punonjes qe jane ne proces gjyqesor.
-971,226,440 leke per gjendjen e llog.ne pritje e cila perbehet nga humbje apo inventare te denoncuar ne organet perkatese dhe per te cilat pritet vendim i formes se prere.
Gjate vitit 2015 eshte kryer rrimarje provizioni per shumen 117,376,067 leke, qe ka te beje me provizionet e krijuara ne vitin 2014 si me poshte:
82,188,961 leke provizion i krijuar per shperblimin per vjetersi per punonjesit e dale te papune ,ne zbatim te VKM nr. 106, dt. 01/02/2012.
35,187,106 leke provizion i krijuar per vendime gjyqesore te pritshme per t'u fituar nga punonjes qe jane ne proces gjyqesor.

Te drejta te arketueshme mund te detajohen me tej si me poshte:

	Te drejta te arketueshme nga aktiviteti shfrytezimit	**3.1**	**Deri 1 vit**	**mbi 1 vit**
1	*Armo sha*		-3,981,550	11,686,473,189
2	*Shteterore*		426,438	339,427,456
3	*Private*		977,390,604	4,382,365,474
			973,835,492	**16,408,266,119**

S 3.4 Te tjera te drejta te arketueshme ne fillim dhe ne fund te ushtrimit paraqiten:

S3.4	**Të drejta të arkëtueshme-Të tjera**	**3.4**	**Viti Ushtrimor 31.12.2016**	**Viti Ushtrimor 31.12.2015**
	Aktive te tjera		**1,294,229,206**	**1,239,141,251**
	Deri 1 vit		76,223,768	40,318,606
	Mbi 1 vit		1,218,005,438	1,198,822,645
	TVSH		57,143,595	51,031,773
	Tatim ne burim		134,280	980,168
	Tatim fitimi		150,358,553	129,150,701
	Akciza		74,836,091	74,836,091
	TAP		2,981,268	2,922,991
	Detyrim per sigurime shoqerore mbi 1 vit		116,293,922	116,239,728
	Te drejta nga kontraktoret		3,348,670,119	1,792,491,648
	Hua te dhena		109,879,332	110,279,332
	Totali		**5,154,526,366**	**3,517,073,683**

